



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMANIZIMIT

Nr. 1281/1 prot.

Tiranë më 8.7.2022

Lënda: Dhënie mendimi për “Draft Marrëveshjen midis Republikës Italiane dhe Republikës së Shqipërisë në fushën e sigurimeve shoqërore”.

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”), ka administruar shkresën tuaj me nr. 12951 prot., datë 04.07.2022, përmes së cilës kërkohet mendim për Draft Marrëveshjen midis Republikës Italiane dhe Republikës së Shqipërisë në fushën e sigurimeve shoqërore.

Nga shqyrtimi i materialit të vendosur në dispozicion, Zyra e Komisionerit vlerëson se, në tërësi nga përmbajtja e saj, draft marrëveshja implementon standardet më të larta të mbrojtjes së të dhënave personale.

Megjithatë, do të vlerësonim marrjen në konsideratë nga ana juaj të sugjerimeve të mëposhtme, që i referohen terminologjisë së përdorur.

Një sugjerim i përgjithshëm i Zyrës së Komisionerit është që, teksti/përkufizimet dhe gjuha e përdorur në përmbajtje Draft/Marrëveshjes të njehsohet me Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim “Ligji”) me qëllim shmangien e paqartësive që mund të krijohen.

Më tej në Aneksin 1 (*Klauzola për transferimin e të dhënave personale ndërmjet Autoriteteve kompetente të përcaktuara në nenin 29 të Marrëveshjes*) bashkëlidhur Draft/Marrëveshjes, sugjerojmë se duhet të përshtaten këto terma/përkufizime:

- Togfjalëshi, “*Të dhënat e veçanta*”, në Kreun I, germa “b” të zëvendësohet me “*Të dhëna sensitive*”.
- Termat “*operacion*” dhe “*tërësi operacionesh*” të cituara në përkufizimin e termit “Përpunim”, në Kreun I, germa “e” të zëvendësohet me termat “*Veprim*” dhe “*Grup veprimesh*”.
- Termi “*Të drejtat e të interesuarve*” në Kreun I, germa “m” të zëvendësohet me “*Të drejtat e subjektit të të dhënave*”.

Me përshtatjen e terminologjisë së përdorur, Draft/Marrëveshja vlerësohet e hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

